



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 28/2022**

Datë: 28. 10. 2022. Ora: 12: 00

Vendi: Peje- Hotel Dukagjini

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Alim Rama, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj dhe Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef, Xhemail Peqani zv KE, Miradije Meha drejtoresh e DAP, Nexhmedin Hyseni drejtor i DKT, Sylejman Gashi auditor, Haki Krasniqi drejtor i DOZ.

Përkthyes: Jehona Cami.

Procesmbajtës: Emira Alushi. U.d drejtororesh e DCL

### **RENDI I DITËS**

**1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të kuvendit komunal në Kamenicë**

**3.Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anetarit të kqz z. Arianit Elshani me z. Ibrahim Selmanaj për pjesëmarrje në udhëtim zyrtar në Tiranë, të organizuar nga IFES**

**4.Te ndryshme**

---

Hyrje, Kryesuesi hapi mbledhjen me dy pika të rendit të ditës.

KQZ miratoi rendin e ditës Nr.28/2022.

Kryesuesi theksoi se, kërkesa për zëvendësim është verifikuar nga departamenti ligjore dhe konsideroi se është e gatshme për miratim.

Kryesuesi i mbledhjes, prezantoi kërkesën për zëvendësim të anëtares së Kuvendit Komunal në Kamenicë.

**KQZ-ja, në mënyrë unanime miratoi kërkesën për zëvendësim në Kamenicë, znj. Albana Ajvazi, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik “Partia Social Demokrate”, duke e zëvendësuar anëtares e Kuvendit Komunal znj. Albina Mahmuti.**

Kryesuesi i mbledhjes, lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, theksoi se pasi që z. Arianit Elshani nuk mund të marrë pjesë në udhëtimin zyrtar në Tiranë të organizuar nga IFES, propozoi që të zëvendësohet me anëtarin e kqz z. Ibrahim Selmanaj.

KQZ, më nëmyrë unanime miratoi zëvendësimin e anëtarit të kqz z. Arianit Elshani me z. Ibrahim Selmanaj, për pjesëmarrje në udhëtim zyrtar në Tiranë, të organizuar nga IFES

Takimi përfundoj në ora 12:15

Të ndryshme !